



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

Legjislatura IV  
Komisioni për Buxhet dhe Financa  
Mbledhja nr. 150/14  
Prishtinë, më 02.04.2014, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**  
**IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA**

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Muhamet Musafa, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama dhe Duda Balje.

Munguan: Naser Osmani dhe Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Besim Beqaj-ministër i financave, Ferid Agani – ministër i shëndetësisë, Agim Krasniqi –drejtor i buxhetit në MF, Arsim Qavdasha-MSh, Haki Sfishta –AKP, Marian Nieora-Drejtor i KPA, Fetije Halitaj-KPA, Idiz Blakaj-Drejtor i AMKMK, Albana Jaha dhe Adron Elshani – AMKMK, Alexandra Fehlinger- GIZ, Rejahana Zylfijaj-GIZ, Haxhi Gashi- USAID.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj Kryetare e Komisionit.

**R e n d i i d i t ë s :**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 26.03.2014 dhe 27.03.2014;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Sigurimin Shëndetësorë, me amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2013;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2013;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-240 për Masat Antidamping dhe Masat Kundërbalancuese, me amendamentet e Komisionit funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregit dhe industri;**
- 7. Të ndryshme.**

**Kryetarja** falenderojë ministrin e finanacave që i është përgjigjur kërkesës së Komisionit për Buxhe dhe Financa dhe ka caktuar dy persona permanent të minisitrisë, z. Agim Kransiqi – drejtor i buxhetit dhe Blerand Kadrijaj – këshilltar i ministrit, si persona kontaktues dhe të përhershëm në takimet e komisionit.

### 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryetarja:** konstatoj se rendi i ditës u miratuar pa ndryshime.

### 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 26.03.2014 dhe 27.03.2014

**Kryetarja:** konstatoj se procesverbalet miratohen pa vërejtje.

### 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Sigurimin Shëndetësorë, me amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

**Ferid Agani:** sqaroi se projektligji për sigurimin shëndetsor është punuar me shumë se dy vite me një bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e Bankës Botërore dhe me FMN-së, por edhe një konsultim të ngushtë me strukturat vendimarrëse vendore, si në radhët e profesionistëve shëndetësor ashtu edhe nga shoqëria civile. Si rezultat i kësaj duke e shfrytëzuar edhe rezultatet e e hulumtimeve që janë bërë në këtë aspekt kemi arritur deri të një projektligj që e ka një kosto minimale të shpenzimeve për atë që synohet, një qasje univertzale qytetarëve ndaj shërbimeve shëndetsore. Sa i përket koston buxhetore, është vlerësuar se për tri vite të jetë dikun 54 milion euro, dhe kjo kosto zërthehet në kontributet të cilat duhen të paguhen nga punëdhënësi në sektorinë publik për të punësuarit e tyre dhe nga sektori privat.

**Kryetarja:** shifet se projektligji gjatë viti 2014 nuk ka kosto buxhetore, por kostoja fillon prej vitit 2015, kur parashihet të hyjë në fuqi ligji, kështu që është mirë me na tregue ministri i finanacave, se qka kanë bërë në këtë drejtim në mënyrë që në vitet pasuese, të parashihet kostoja buxhetore për zbatimin e ligjit.

**Besim Beqaj:** unë mëndo që është një ndër ligjet më të rëndësishme që i kemi proceduar deri më tani, ligji që është diskutuar gjatë dhe besoj që adreson shumë probleme në sektorin e shëndetsisë por edhe në sektorin privat. Ligji parasheh që të ketë pjesëmarrje të barabartë të punëdhënësve edhe të punonjësve në qoftë në sektorin publikë e qoftë në sektorinë privat, përmes premiumit i cili do të jetë 3.5%. Kostoja preliminare për sektorin publik që është kostoja e drejtpërdrejtë buxhetin është dikun rreth 18.5 milion eur në shuma nominale. Mjetet që janë ndarë për shërimet jashtë vendit, do të alokohen për këtë fond, dhe kjo do të ndikojë që vlera e koston buxhetore të jetë më e ultë se sa është vlerësuar. Ne konsiderojmë se shuma e fondit fillestar të jetë diku prej 80 milion euro, dhe si pjesëmarrje në buxheti rreth 18.5 milion euro. Kostoja është e përbalueshme dhe do të jetë në kornizën afatmesme dhe vlersimet tona për tri vite në total do të jenë rreth 54 milion euro. Një efekt tjetër anësorë pozitiv i cili pritët të bëhet është rritje e ofrimit të shërbimeve shëndetsore brenda vendit, sepse kemi një sasi të madhe të parave që kanë dal jashtë vendit për shërbime shëndetsore dhe kjo në mënyrë të drejtëpërdrejt reflekton në buxhet dhe tani këto shërbime do të ofrohen këtu dhe do të ketë të hyra më të mëdha buxhetore. Ne bashkë me ministrinë e shëndetësisë jemi në fazën përfundimtare të diskutimit me bankën botërore për një hua tjetër dikun 25 milion dollar për reformën në shëndetësi, që realisht përmbillet një cikël i fazës së parë të reformës edhe të sektorit të shëndetsisë .

**Kryetarja:** nga diskutimet po shifet se qëndrimet janë të harmonizuar mes dy ministrive. Ministria e shëndetsisë ka siguruar edhe fonde për me pas mundësi me e zbatue ligjin, edhe ministri i finanacave u

deklaru se është e përballeshme për buxhetin e Kosovës dhe do të pjesë e kronizes afatmesme të shpenzimeve.

Pas diskutimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

### **Rekomandim**

1. Projektligji për Sigurimin Shëndetësor, përmban kosto buxhetore të përballeshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionin Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për Projektligjin për Sigurimin Shëndetësorë, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

#### **4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2013**

**Kryetarja:** raporti vjetor financiar i AKP-së për vitin 2013 është përgaditur sipas formularëve standard dhe si i tillë pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar të agjencionit të viti 2013 si dhe të dhënat për buxhetin e shpenzuar sipas kategorive edhe nënkategorive ekonomike. Po ashtu është bërë krahasimi për vitin paraprak siç është kërkuar në formularet e raportimit. Në këta formularë standard nuk janë përfshi donacionet, mirëpo në raport të punës janë evidnetuar ato. Nga raporti shofim se buxheti është shpenzuarë 97.26 % në total.

**Marian Nieora:** jemi të kënaqur që e kemi këtu raportin dhe për të dhënë sqarimet më në detale dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja, e sugjerojë zyrtarin financiar të AKP-së, që të ofrojë këto të dhëna.

**Haki Sfishta:** sqaroi se AKP gjatë vitit 2013 e ka pasur buxhetin të miratuar prej 1,782,771 euro, ndërsa me rishikim të buxhetit, janë bërë ndryshime apo rialokime të brendshme, nga pagat dhe mëditje dhe shpenzime kapitale në mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale. Buxheti në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje është shpenzuar prej 99.84% . Sa i përker kategorisë mallra dhe shërbime në fillim të viti 2013 ka qenë shuma më e ulët se sa nevojat me rastin e rishikimit e harmonizimit kemi janë shpenzuar 94.45%, ndërsa shpenimet komunale janë realizuar prej 92.87%. Në kategorinë e subvencioneve duke marr parasysh marrëveshjen për transferimin e kompetencave në mes të qeverisë së Kosovës për pagesën e drejtorit, me aprovimin e ministrisë së finanacave, prej pagave e mëdijeve i kemi transferuar mjetet në subvencione dhe janë shpenzuar qinpërqind. Shpenzimet kapitale janë shenzuar 98.5%. Në përgjithsi buxheti i AKP-s- për vitin 2013 është shfrytëzuar prej 97.26%.

**Latif Gashi:** kemi një raport të përgaditur mirë dhe është dorëzuar me afat dhe konform normave ligjore. Shihet se kjo organizat buxhetore e ka menaxhuar mirë buxhetin, në të gjitha kategoritë dhe nënkategoritë nuk ka ndryshim apo bartje të buxhetit dhe nuk ka tejkalim të shpenzimeve në nga ajo që është planifikuar.

**Muhamet Mustafa :** unë mendoj se raporti është mjaft mirë i përgaditun dhe gjinden informatat e nevojshme. Por dy qështje kisha me i potencue që duhet të keni kujdes për të ardhmen. E para janë shpenimet e mëdha për karburantë që duhet analizuar në mënyrë kritike. E dyta është qiraja që është një ngarkesë e madhe që kap shumën prej 189,000 që është obligim i madh për buxhetin.

**Haki Sfishta:** lidhur me shpenzimet e karburantit, ju njoftoj se agjensioni i ka 50 vetura duke marr parasysh shpërndarjen e agjencionit në zyrën regjionale dhe punën që e bëjnë në teren lidhur me verifikime e kontrollimin e pronave edhe shqyrtimin e lëndëve të cilat vinë. Për qiranë e theksuat edhe

ju se për ndërtesën kryesore, mirëpo i kemi edhe qiratë për zyret regjionale.

**Latif Gashi:** shpenzime për vetura a bëhen vetëm brenda territorit apo edhe për aktivitetet jashtë territorit të Kosovës?

**Haki Sfishta:** shpenzimet për vetura, janë për brenda dhe jashtë territorit të Kosovës. Kemi lëndë që dërgojmë dhe marrim në qytetet e Serbisë apo Mal të Zi dhe për këtë qëllim shfrytëzohe vetura tona.

**Kryetarja:** këto shpenzime për vetura dhe qira, të analizohen dhe të jepet arsyshëmëria me rastin e miratimit të buxhetit të ardhshëm për këtë agjencion.

Pas diskutimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

### **Rekomandim**

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2013.

### **5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2013**

**Kryetarja:** thekson se ky agjencion ka fillu punën pak me vonesë dhe ne si anëtarë të komisionit e dijm edhe rrjedhën e financimit dhe problemet të cilat u përball ky agjencion. Megjithat ky agjencion edhe pse ka fillu punën me vonesë, ju ka përgjigjë kërkesës ligjore, e ka hartuar raportin e puns dhe atë financiar dhe shifet se shpenzimi i buxhetit është bërë dikun 72% në total.

**Idriz Blakaj:** ju e dini se agjencion është themeluar në prill të vitit 2013. Me rishikim të buxhetit është miratuar buxheti që është shpërndarë nëpër kategori dhe për shpenzime kapitale janë bartë mjetet për Projektin Memorial të Prekazit, ndërsa punëtorët nuk janë bartur. Gjatë përpilimit të buxhetit të viti 2014 mua si drejtor i agjencionit më kanë ardhur tri shkresa prej ministrisë së financave ku janë lejuar një herë 11 punëtor, e të dytën 7 punëtor dhe në të tretën kanë qenë për 3 punëtor. Sa i përket shpenzimeve kapitale, është bartë vetëm projekti i Prekazit, me arsyetimin se janë projekte në vazhdim. Unë e kam cek se projekte në vazhdim ka qenë dy, Krusha e Madhe edhe Zahir Pajaziti, të tjerat projekte tjera nuk kanë pas kontrata për vitin 2014. Mosbartja e projekteve është shkelje e ligjit.

**Kryetaja:** thekson se po të ishim të fuqishëm si komision për buxhet dhe financa, me i pas disa kompetenca vendimarrëse, ndryshe kishim veprue sepse kemi qenë kunder të themelimit të agjencionit si i pavarur, arsyeja ka qenë se janë bërë shumë agjencione të pavarura në kuadër të Kuvendit. Ne kemi analizuar shumë mirë në komisionin për buxhet, mirëpo insistimet kanë qenë që ky agjencion të formohet si i tillë dhe Kuvendi ka vendosur të themelohet. Në rishikimin e buxhetit, e kemi miratuar këtu në komision për me u tranferue tre punëtorët në kuadër të këtij agjencioni nga MMPH. I nderuari ministër i ambientit, na ka thënë se i tranferoj të punësuarit dhe kjo ministri gjatë viti 2013 nuk i ka transferu këta 3 të punësuarit dhe e ka bartur vetëm projektin e Prekazit. Nga raporti po shifet se për këtë projekt, punët e filluara janë kryrt mbi 50% e pagesa ka mbri dikun 72% e shumës totale .

**Latif Gashi :** realisht Kuvendi ka gabuar që i ka bërë 40 agjencione, që janë krijuar shpenzime të mëdha buxhetore për të gjitha kategoritë dhe ngarkesë në logjistikë dhe propozojë që të formojmë një grup

punues që të merremi me gjitha këto agjenci dhe të zvoglojmë këto agjensione. Por ne sot e kemi raportin financiar të këtij agjensioni që është përgaditur në mënyrë profesionale. Për 2014 shihet ne iu kemi ndarë 4 punëtorë dhe jemi në muajin e katërt, desha të dija a janë marrë këta punëtor? Si Agjencion iu nevojitet kohë për tu fuqizuar për të realizuar projektet për të cilin jeni themeular. Ministria e Mjedisit, e ka pasur më lehtë të kryejë këto projekte se ka më shumë staf dhe eksperta.

**Sevdije Lama:** njoftojë se në komisionin funksional e kemi diskutuar raportin e punës të këtij agjensioni dhe nuk e di pse thuhet këtu se komisioni e ka shkelur ligjin. Unë dje e kam bërë pyejten në rast se nuk ka disponim Ministria e Mjedisit për bartjen e 3 punëtorëve, pse nuk janë bartur edhe projektet e reja nga Ministra e Mjedisit, në të kundërtën pse me ekzistue ky agjencion, vetëm për menaxhimin e kompleksit të Jasharave!

**Agim Krasniqi:** thekson se në momentin që është nis iniciativa për këtë agjencion, ne e kemi dhënë rekomandimin tonë si ministri. Pas themelimit të agjencisë nga Kuvendi, ne kemi bërë përpjekje me ulë ministrin e mjedisit dhe kryeshefin ekzekutiv me bisedue për ndarjen e buxheti e të stafit, e mjerisht ne nuk kemi arritur të organizojmë takimin dhe në komisionin për buxhet e financave është vendosur për numrin e punëtorëve edhe për buxhet. Ministria e Financave nuk mundet me dal jashtë funksioneve që ka edhe nuk ka mundur me bartë buxhetin pa i pas dokumentet zyrtare që tregojnë gjendjen dhe vazhdimësinë e projekteve. dhe vazhdimësinë për projekte.

**Kryetarja:** ne jemi përpjek me e zgjedh këtë problem, por nuk kemi mundur me ba zgjidhje. Përkundër kësaj, në momentin kur ligji është miratuar dhe Agjencioni është dashur të funksionalizohet, është dashur ti ndahet buxheti agjencionit dhe të funksionojë sipas ligjit. Nuk jam eksperte apo personi kompetent me ba analizën e duhet me u bart projektet të cilat janë në vazhdimësi apo nuk duhet me u bartë, atë duhet me komentu dikush tjetër që merret me këtë qësjtje.

**Idriz Blakaj:** spo e thëmë se është agjencioni më i rëndësishëm, por është ndër më të rëndësishmit dhe mundet me u fol për shumë agjensione, por jo për këtë agjencion, veq e dini se kujt i kushtohet dhe do të duhej me na lirue mjetet.

**Latif Gashi:** e kuptojë pozitën e drejtorit se duhet me qenë avokat i mirë i agjencionit, e shqetësimi im është i përgjithshëm për gjitha agjencionet e pavarura. Unë e kuptoj rëndësinë e agjencionit, por realisht kisha pas dëshirë të jeshë ti në kuadër të ministrisë dhe jo me u bë agjencion i ri.

**Kryetarja:** nuk mundemi me formue grup punues sepse janë 30 ligje që duhet me u ndryshue, që me pas mundësi me i reduktu këto agjensione. Qka ne mundemi me bë është të bëjmë një analiz rreth financave dhe të mënyrës së funksionimit të këtyre agjensioneve dhe të debatojmë në Kuvend dhe të mirret një vendim por me atë vendim të fillon iniciativa për ndryshimin e ligjeve edhe pozicionimin e agjensioneve ku e kanë vendin.

Pas diskutimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

### **Rekomandim**

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2013.

**6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-240 për Masat Antidamping dhe Masat Kundërbalancuese, me amendamentet e Komisionit funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregit dhe industri**

**Kryetarja:** nga analiza që është bërë shifet se PL dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

**Rekomandim**

Projektligjit nr.04/L-240 për Masat Antidamping dhe Masat Kundërbalancuese, dhe amendamentet e Komisionit funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregit dhe industri, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

**Mbledhja përfundoi: 12:15**

**Përgatitur nga:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetarja e Komisionit**

---

**Safete Hadergjonaj**